



Raport Kombëtar

Shqipëria



Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	4
Përmbledhje e kuadrit legjislativ dhe institucional mbi sipërmarrjen sociale	6
Përmbledhje e nismave të politikave për të rinjtë për qytetarinë aktive dhe sipërmarrjen sociale	8
Mundësitë për sipërmarrje sociale për të rinjtë	10
Sfidat e sipërmarrjes sociale për të rinjtë	13
Roli i qeverisë vendore dhe institucioneve arsimore në mbështetjen e sipërmarrjeve sociale të të rinjve	16
Rekomandime për mekanizmat mbështetës dhe burimet arsimore/trajnuese për të rinjtë që të përfshihen në sipërmarrjen sociale	19
Përmbyllje	21
Referenca	23
Shtojca	24

***Praktikat dhe iniciativat më
të mira në qytetarinë aktive dhe sipërmarrjen
sociale tek të rinjtë***

24

Hyrje

Projekti EPIC është konceptuar duke njohur rolin transformues që Qytetaria Aktive mund të luajë në shoqëri, duke krijuar hapësira për veprime dhe iniciativa të udhëhequra nga qytetarët për të adresuar çështjet dhe sfidat sociale, që veprojnë si shtytëse të ndryshimit. Për më tepër, Sipërmarrja Sociale perceptohet si një formë biznesi që është e ndërlidhur me Qytetarisë Aktive dhe si shprehje e saj. Kështu, ky projekt pasqyron dhe bazohet në Programin e Bashkimit European për Punësimin dhe Inovacionin Social - EASI (2020) që thotë se “Krijimi I ndërmarrjeve sociale përforcohet nga angazhimi social dhe qytetar i grupeve të qytetarëve. Iniciativa të drejtuara nga qytetarët janë ndërmarrë, ku grupe qytetarësh kanë krijuar organizata, shpesh si vullnetarë dhe me pak burime në dispozicion, për të adresuar nevojat dhe sfidat shoqërore dhe/ose për të integruar njerëzit që vijnë nga mjedise që nuk ofrojnë shumë mundësi për të përparuar”.

Duke bashkuar parimet dhe konceptet e qytetarisë aktive dhe sipërmarrjes sociale, projekti do të punojë drejt ngritjes së bazave dhe fuqizimit të punonjësve rinorë dhe të rinjve në Ballkanin Perëndimor për të promovuar një mentalitet më aktiv që do të inkurajojë dhe mbështesë të rinjtë të identifikojnë çështjet dhe problematika sociale dhe të strukturojnë ide për ndërmarrje sociale për ti adresuar këto problematika.

Objektivat e projektit EPIC janë:

- Fuqizimi i punonjësve rinorë, të rinjve, organizatave rinore dhe sipërmarrësve të rinj për të zhvilluar aftësitë dhe kompetencat e tyre sipërmarrëse sociale, si një mënyrë për të zhvilluar më tej ndërmarrjet sociale dhe për të nxitur pjesëmarrjen qytetare dhe qytetarinë aktive.

- Identifikimi i çështjeve dhe sfidave sociale që kërkojnë përgjigje nga qytetarët dhe të rinjtë në mënyrë që të zgjidhen.
- Edukimi i punonjësve rinorë mbi çështje kryesore sociale, përkufizimin se çfarë është sipërmarrja sociale dhe potencialin që ajo ka për impakt të qëndrueshëm dhe pjesëmarrje qytetare. Duke integruar trajnimet, mbështetjen dhe advokimin, EPIC është përkushtuar për të edukuar një brez të ri sipërmarrësish sociale që janë të ndërgjegjshëm dhe të gatshëm për të pasur një ndikim të qëndrueshëm e pozitiv në komunitetet e tyre.

Kërkimet në projektin EPIC u udhëhoqën nga KMOP – Qendra e Arsimit dhe Inovacionit, Greqi dhe u kryen nga vendet partnere në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë. Kërkimet bazohen në një qasje të strukturuar që kanë për qëllim zhvillimin e një Programi Trajnimi gjithëpërfshirës për të edukuar dhe zgjeruar konceptin dhe botëkuptimin e punonjësve rinorë, ashtu edhe të të rinjve mbi Qytetarinë Aktive dhe Sipërmarrjen Sociale.

Kjo metodologji shpaloset përmes studimeve online dhe në terren, duke rishikuar literaturën ekzistuese dhe duke përdorur fokus grupe dhe anketime për të kuptuar njohuritë e punonjësve rinorë dhe të të rinjve mbi sipërmarrjen sociale në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë. Rezultatet nga studimet kërkimore dhe në terren janë pasqyruar në këtë raport kombëtar.

Studimi përfshiu analizën e politikave, praktikave dhe raporteve ekzistuese në Shqipëri. Më tej u organizua **një fokus grup me punonjës rinorë**, i cili dha njohuri mbi nevojat, sfidat dhe mundësitë e të rinjve për t'u angazhuar në sipërmarrjen sociale. Pjesëmarrësit ndanë përvojat e tyre personale dhe vëzhgimet profesionale mbi këtë temë.

Gjithashtu, në Shqipëri u zhvilluar **2 sondazhe**. Një sondazh për punonjësit rinore (25 të anketuar) dhe një sondazh drejtuar të rinjve (29 të anketuar). Sondazhi nxorri në pah sfidat dhe nevojat që lidhen me sipërmarrjen sociale midis të rinjve dhe punonjësve rinorë.

Përmbledhje e kuadrit legjislativ dhe institucional mbi sipërmarrjen sociale

Hapat e parë për hartimin e një kuadri ligjor për sipërmarrjen sociale në Shqipëri nisën në vitin 2010 me iniciativën e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (tani Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale). Në vitin 2016, qeveria shqiptare miratoi ligjin 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Që nga viti 2016 është kompletuar paketa ligjore, përkatësisht me vendimet dhe direktivat e mëposhtme:

- Vendimi nr. 16/2017 “Për përcaktimin e procedurave për kryerjen e kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale”;
- Vendimi nr. 16/2018 “Për miratimin e listës së veprimtarive të kryera nga ndërmarrjet sociale”;
- Vendimi Nr. 56/2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve me disavantazhe”;
- Udhëzim nr. 607/2018 “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale”;
- Udhëzim nr. 677/2018 “Për përcaktimin e formave, afateve dhe mënyrave të raportimit periodik, për veprimtaritë e kryera dhe kategoritë e personave të punësuar në ndërmarrjet sociale”;
- Vendimi nr. 789/2018 “Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes me subvencione për ndërmarrjet sociale”;

- Urdhëri nr. 636/2018 “Për miratimin e rregullores standarde për funksionimin e ndërmarrjeve sociale”;
- Udhëzim nr.2/2019 “Për krijimin e regjistrit të ndërmarrjeve sociale dhe rregullat për mbajtjen e tij”.
- Udhëzim nr. 376/2020 “Për kriteret e granteve dhe mekanizmin e monitorimit të ndihmës shtetërore për sipërmarrjen sociale”
- Vendimi Nr. 174/2023 “Për përcaktimin e formave të mbështetjes përmes subvencionimit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2023-2025”

Sipas ligjit 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë” statusin e ndërmarrjes sociale mund ta marrin vetëm organizatat jofitimprurëse që ofrojnë mallra dhe shërbime në përputhje me nevojat e komunitetit në sektorët e: shërbimeve sociale, shërbimeve shëndetësore, kulturës dhe arsimit, promovimin e turizmit dhe mbrojtjen e mjedisit, ndërmjetësimit për kualifikim për punësim dhe punësimin e të rinjve.

Përsa i përket kriterëve ekonomike, ligji shqiptar parashikon që ndërmarrjet sociale të prodhojnë vazhdimisht mallra dhe/ose të ofrojnë shërbime. Gjithashtu ai specifikon se, një ndërmarrje sociale duhet të gjenerojë 20% të ardhurave nga aktiviteti ekonomik pas vitit të dytë dhe 30% e të ardhurave të gjenerohet nga aktiviteti ekonomik pas vitit të tretë. Përveç përfshirjes së vullnetarëve, një ndërmarrje sociale duhet të punësojë të paktën tre punëtorë me kohë të plotë me pagesë (neni 8). Lidhur me kriteret sociale, ligji parashikon që 30% e punonjësve të vijnë nga grupe të marginalizuara (neni 9). Sipas këtij ligji, pavarësisht se ndërmarrja shoqërore është e detyruar të përdorë “fitimin tërësisht për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së saj” (neni 17), ajo duhet të tatohet edhe për fitimin, sipas legjislacionit në fuqi mbi të ardhurat tatimore.

Ndërmarrjet sociale njihen në dy nga dokumentet zyrtare të qeverisë shqiptare: Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2023-2030 dhe Strategjia e Investimeve dhe Biznesit për 2021 - 2027. E para njih nevojën për zhvillimin dhe promovimin e ndërmarrjeve sociale, e cila parashikohet të bëhet nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të masave të sipërmarrjes sociale dhe krijimit e kushteve për të nxitur punësimin në sektorin e tretë. Dokumenti i dytë zyrtar thotë se duhet dialog i vazhdueshëm midis të gjitha palëve të interesuara për të zhvilluar modele të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse biznesi dhe për të pasur një gamë më të gjerë të formave të biznesit.

Përmbledhje e nismave të politikave për të rinjtë për qytetarinë aktive dhe sipërmarrjen sociale

Ligji Nr. 75/2019 dhe Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029 mbeten dokumentet kryesore ligjore që nxisin rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve. Ligji Nr. 75/2019 përcakton dhe njih mekanizmin e “dialogut të strukturuar” si një mjet për pjesëmarrjen e të rinjve.

Nga ana tjetër, Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029 në deklaratën e saj të objektivave thekson se ka prioritet pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrjen lokale dhe kombëtare, në organizatat rinore dhe në jetën komunitare.

Strategjia ka tre objektiva kryesore në politikat e saj, secila me disa nën-objektiva specifike. Objektivi numër një fokusohet në pjesëmarrjen e të rinjve dhe thekson se: “djemtë dhe vajzat e reja marrin pjesë në mënyrë aktive në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për të shprehur veten me zërin e tyre. Bazuar në analiza të ndryshme, politikat e ndërthurura rinore janë të koordinuara dhe me mekanizma të mirëfinancuar”.

Objektivat specifike 1.1 theksojnë: “Të rinjtë janë të informuar për mundësitë për të mësuar, për të fituar përvojë organizative dhe

vullnetare dhe për të marrë pjesë aktive në jetën qytetare, sociale dhe politike”. Autoriteti përgjegjës për zbatimin e strategjisë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë janë autoritetet kryesore për zbatimin e objektivit numër një me fokus pjesëmarrjen.

Në objektivin specifik 2.1 në seksionin e Strategjisë, është theksuar si sfidë - puna e zgjeruar për përhapjen e sipërmarrjeve sociale bazuar në direktivat e hartuara në lidhje me këtë formë biznesi.

Ligji për Rininë në Shqipëri (2019), i cili nxjerr në pah rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse, është shembull i një kuadri ligjor dhe rregulloreje që është krijuar për të lehtësuar pjesëmarrjen e të rinjve. Megjithatë, ka ende punë për të bërë përsa i përket mënyrës se si këto ligje dhe rregullore do të zbatohen në praktikë dhe si do të ndikojnë në fuqizimin e të rinjve. Niveli i aksesit në burime dhe mundësi për të rinjtë varet nga zonat ku ata jetojnë. Kjo sjell edhe pabarazi në angazhimin e të rinjve. Ligji për të rinjtë 75/2019 shtyn të rinjtë të angazhohen në jetën shoqërore dhe politike, por nuk ka nene të veçanta për përfaqësimin politik.

Ligji 75/2019 parashikon krijimin edhe të Këshillave Rinore Vendore. **Këshilli Rinor Vendor** shërben si një mekanizëm ndërlidhës mes bashkisë dhe komunitetit rinor, për të identifikuar problemet dhe sfidat me të cilat përballen të rinjtë në territorin ku jetojnë, si dhe për të rritur përfshirjen e tyre në politikë. Këto struktura të rëndësishme dhe shërbejnë si urë lidhëse mes bashkisë dhe të rinjve, duke vënë në pah problemet dhe sfidat me të cilat përballen të rinjtë në zonën ku jetojnë. Numri i bashkive që kanë themeluar Këshillat Rinor Lokal është aktualisht i ulët.

Për më tepër, në Shqipëri kemi **Këshilli Rinor Kombëtar**, i cili është një organ këshillimor që funksionon në varësi të ministrit përgjegjës për rininë. Ai përbëhet nga të rinj, përfaqësues të organizatave të fokusuara

tek të rinjtë dhe përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Rinisë, me qëllim këshillimin mbi politikat dhe strategjitë rinore.

Edukata Qytetare është pjesë përbërëse e kurrikulës në shkollat Shqipëtare. Kjo lëndë synon t'i pajisë studentët me njohuri për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si qytetarë, si dhe me aftësi për pjesëmarrje aktive në proceset demokratike. Kuadri ligjor në Shqipëri ofron të drejtën e arsimimit për të gjithë fëmijët, pavarësisht nevojave dhe aftësive të tyre të veçanta. Nga ana tjetër, OJF-të në sektorin e rinisë në Shqipëri ka promovuar dhe integruar edukimin qytetar përmes arsimit jo-formal dhe projekteve të financuara nga donatorët. Këto përpjekje synojnë të nxisin një mjedis që inkurajon pjesëmarrjen aktive në shoqëri dhe promovon mësimin gjatë gjithë jetës tek qytetarët Shqiptarë.

Mundësitë për sipërmarrje sociale tek të rinjtë

Edukimi mbi sipërmarrjen është një fushë e kohëve të fundit në Shqipëri dhe po zhvillohet për të rritur qëndrimet dhe aftësitë sipërmarrëse të studentëve dhe të rinjve. Qëllimi është të mbështesë studentët për të pasur një qasje të pavarur dhe të gjithanshme duke rritur frymën e sipërmarrjes. Shqipëria ka adaptuar disa politika dhe korniza pune Europiane në lidhje me edukimin për sipërmarrjen, si Korniza Europiane e Kompetencës për Sipërmarrjen (EntreComp), e cila përcakton 15 kompetenca që karakterizojnë mentalitetin dhe sjelljen e një sipërmarrësi.

Shqipëria mirëpret shumë organizata ndërkombëtare që synojnë të mbështesin qeverinë dhe tregun për të përmirësuar punësimin e të rinjve dhe sipërmarrjen e të rinjve.

Mund të përmëndim disa si më poshtë, por kjo listë nuk është shterësuese:

BE për Inovacionin – Kjo është një nismë që synon të mbështesë zhvillimin e bizneseve inovative në Shqipëri dhe ofron një sërë shërbimesh, duke përfshirë trajnime, mentorim dhe mundësi financimi për sipërmarrësit e rinj. Faqja e tyre e internetit ofron informacione rreth programeve, eventeve dhe historive të suksesit.

Start-up Rajonal për Zhvillimin e Ekosistemit – Kjo faqe ofron informacion mbi programin rajonal të start-up-eve për zhvillimin e ekosistemit, i cili është krijuar për të mbështetur zhvillimin e start-up-eve në Ballkanin Perëndimor. Programi ofron mundësi trajnimi, mentorimi dhe rrjetëzimi për sipërmarrësit e rinj, si dhe akses në financim dhe burime të tjera.

Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit – Ky fondacion ofron mbështetje për sipërmarrësit e rinj në Shqipëri nëpërmjet një sërë programesh, duke përfshirë inkubimin e biznesit, mentorim dhe aksesin në financim. Faqja e tyre e internetit ofron informacion mbi programet e tyre, historitë e suksesit dhe burime të tjera për sipërmarrësit e rinj.

GIZ – Është një agjenci gjermane e zhvillimit që ofron mbështetje për sipërmarrësit e rinj në Shqipëri dhe vende të tjera. Faqja e internetit ofron informacion mbi programet, historitë e suksesit dhe burime të tjera për sipërmarrësit e rinj.

Në kuadër të **sondazheve dhe fokus grupeve** të zhvilluara nga **Organizata “People in Focus”** në kuadër të projektit EPIC disa gjetje me rëndësi u evidentuan.

Pjesëmarrësit në Fokus Grupin me Punonjësit rinorë, theksuan disa mundësi që ofrohen nga subjekte të ndryshme për të ndihmuar të rinjtë të fillojnë ndërmarrjen e tyre sociale. Edhe pse, ka vetëm pak mundësi të dedikuara posaçërisht për sipërmarrjet sociale.

Për shembull, organizata Partnes

Albania ofron prona të konfiskuara nga krimi i organizuar, për t'u përdorur nga sipërmarrësit socialë. Për më tepër, ekzistojnë mundësi financimi nga donatorë të ndryshëm që e japin mbështetjen e tyre përmes konkurseve të startup-eve apo formave të tjera. Gjithashtu disa ambasada, si Ambasada Britanike, u ofrojnë mundësi të rinjve në zonat rurale për të ndërmarrë iniciativa sipërmarrëse të cilat mund të jenë edhe sociale. Nisma ka nisur si një mënyrë për të ndaluar migrimin në këto zona. Megjithatë, nevojitet shumë punë për të bërë për të informuar të rinjtë për këto mundësi ekzistuese dhe se si ata mund t'i shfrytëzojnë ato.




Figura 1 Lloji i mbështetjes që u ofrohet sipërmarrësve të rinj socialë nga punonjësit rinorë

Sipërmarrësit e rinj socialë kanë mbështetje nga punonjësit rinorë. Sipas anketës së kryer me punonjësit rinorë, 84% e tyre u përgjigjën se

i mbështesin sipërmarrësit e rinj socialë me burime apo punëtori edukative, 60% me anë të mentorimit, 52% me anë të rrjetëzimit dhe vetëm 4% me trajnime.




Figura 2 Lloji i mbështetjes më të dobishme për sipërmarrësit e rinj socialë

Nga ana tjetër, të rinjtë u përgjigjën se mbështetja më e dobishme për ta janë programet e mentorimit dhe mundësitë e rrjetëzimit (62%), grantet financiare ose investimet (59%) dhe punëtoritë ose trajnimet (45%). Duket se ka një boshllëk komunikimi midis punonjësve rinorë dhe të rinjve, duke i penguar të rinjtë të përdorin plotësisht mbështetjen e disponueshme për ta.

Sfidat e sipërmarrjes sociale për të rinjtë

Edhe pse është bërë një hap i rëndësishëm me futjen e Ligjit për Ndërmarrjet Sociale, përfaqësuesit e sektorit nuk janë të kënaqur me fushën e veprimit të tij dhe kanë kërkuar ndryshime shtesë. Megjithatë shume pak ndryshime janë bërë; ligji mbetet kryesisht i njëjtë. Për më tepër, ata theksuan se legjislacioni aktual mbivendos dy lloje të

ndryshme të aktiviteteve, si shërbimet sociale dhe integrimi në punë. Kjo qasje përjashton shumë ndërmarrje sociale që ose ofrojnë shërbime sociale ose integrojnë grupe të marginalizuara, por kryejnë aktivitete të tjera ekonomike. Shteti shpërfill rëndësinë e aspekteve ekonomike për ndërmarrjet sociale që mund të forcojnë qëndrueshmërinë dhe kapacitetin e tyre për të përmbushur kriteret sociale. Një çështje tjetër ligjore ka të bëjë me subjektet që plotësojnë kriteret për t'u konsideruar sipërmarrje sociale sipas përcaktimit të BE-së, por që nuk janë në gjendje të njihen si të njëjta në këtë sektor në Shqipëri.

Zhvillimi i sipërmarrjeve sociale nga të rinjtë në Shqipëri është veçanërisht sfidues. Bazuar në kontributin e punonjësve rinorë të përfshirë në fokus grup, arritja e statusit të ndërmarrjes sociale kërkon anëtarësimin në një organizatë. Bëhet përgjegjësi e organizatës ta regjistrojë atë dhe të tatohet si biznes me numër NIPT-i. Në këtë rast nuk ka asnjë përfitim të kesh statusin e sipërmarrjes sociale. Nëse organizata promovon haptazi ndërmarrjen sociale, krijohet vështirësi në marrëdhënien me donatorë të ndryshëm. Të kesh statusin e ndërmarrjes sociale duket se ka më shumë kufizime sesa përfitime. *Duket se ka shumë pak gjasa që të arrihet suksesi, përveç kur ka mbështetje nga fondet e BE-së.*

Bazuar në kuadrin ligjor, ndërmarrjet sociale duhet të kenë të paktën 30% të stafit nga grupet vulnerabël në mesin e punonjësve të tyre. Megjithatë, ka një boshllëk në ligj, sepse nuk gjendet asnjë mënyrë për të provuar se një person i përket një grupi të caktuar vulnerabël, kjo bazohet në vetëdeklarim. Për shembull, nëse dikush është i papunë, rrjedhimisht ai/ajo regjistrohet në zyrën e punës. Megjithatë për disa kategori të tjera është e vështirë të kesh një dokument konfirmimi.

Nga ana tjetër, kuadri ligjor nuk është i qartë dhe nuk ka ulje taksash për ndërmarrjet sociale. Ndërmarrjet sociale trajtohen si biznese të

rregullta të cilat kanë gjopa nëse nuk respektojnë nenet e ligjit, por shumë pak incentiva. Për këto arsye, organizatat hezitojnë të aplikojnë për të marrë statusin e ndërmarrjes sociale.

Për më tepër, për të marrë statusin e ndërmarrjes sociale, duhet të aplikohet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale.




Figura 3: Sfidat me të cilat përballen të rinjtë kur nisnin sipërmarrjet e tyre

Sondazhi evidentoi sfida të tjera me të cilat përballen sipërmarrësit e rinj socialë në Shqipëri. Sipas punonjësve rinorë, mungesa e financimit (88%), mungesa e mbështetjes nga komuniteti (60%) dhe mungesa e aftësive të administrimit të një biznesi dhe sfidat rregullatore (56%) janë sfidat kryesore me të cilat përballen sipërmarrësit e rinj socialë.



Figura 4 Sfidat me të cilat përballet ose parashikohet të përballen në ndjekjen e sipërmarrjes sociale

Nga këndvështrimi i të rinjve, aksesimi në financim (55%), ndërtimi i një rrjeti të përbashkët (52%) dhe balancimi i kohës dhe përgjegjësisë (41%) janë sfidat kryesore kur bëhet fjalë për ndërmarrjen e nismave të tilla.

Roli i qeverisë vendore dhe institucioneve arsimore në mbështetjen e sipërmarrjeve sociale të të rinjve

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është institucioni kryesor përgjegjës për hartimin e politikave për promovimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve sociale.

Shërbimi Social Shtetëror është një institucion i varur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përgjegjëse për zbatimin e politikave të ministrisë.

Një rol të rëndësishëm që kanë njësitë e qeverisjes vendore:

1. Njësitë e qeverisjes vendore mbështesin dhe zbatojnë politikat e zhvillimit të sipërmarrjeve sociale në territorin e juridiksionit të tyre.
2. Njësitë e qeverisjes vendore rrisin përfshirjen e ndërmarrjeve sociale në procedurat e prokurimit publik, sipas kushteve të legjislacionit në fuqi.

Megjithëse rolet dhe funksionet e çdo institucioni publik mund të jenë të qarta dhe të duken të dobishme për sipërmarrësit e rinj, por punonjësit rinor ndajnë një mendim tjetër. Ata theksuan në fokus grupin që u zhvillua se për këtë temë është bërë shumë pak nga qeveria.

Ata u shprehën se qeveria duhet të organizojë konsultime dhe të marrë parasysh sugjerimet e dhëna. Pjesëmarrësit në fokus grup sugjeruan se Pushtetet vendore mund të ofrojnë objekte pa qera për të hapur ndërmarrje sociale ose për të zgjeruar aktivitetet e tyre në ato ekzistuese. Një mënyrë tjetër mund të ishte vendosja e ndërmarrjeve sociale në ndërtesat publike, gjë që do të ishte një mbështetje e madhe. Gjithashtu, ata sugjeruan se në formë nxitjeje mund të mbulohen sigurimet shëndetësore dhe kontributet shoqërore për një periudhë të caktuar kohore dhe madje të kontribonin në pagat e para derisa sipërmarrja të kishte mundësi të përparonte.

Qeveria duhet të promovojë ndërmarrjet sociale duke ndryshuar kuadrin ligjor, të cilit i mungon dhe përkufizimi i ndërmarrjes sociale. Ajo duhet të inkurajojë ndërmarrjet sociale përmes politikave mbështetëse. Institucionet përkatëse mund të bëjnë kërkime mbi praktikat më të mira në vendet e huaja dhe t'i zbatojë ato sipas situatave në vendin tonë.

Për më tepër, dokumentacioni që kërkohet për aplikim, për marrjen e statusit është problematik. Udhëzimet janë evazive dhe ka mungesë transparence. Duhet të krijohet një institucion i dedikuar transparent për të ndihmuar plotësisht ndërmarrjet sociale dhe për t'i mbështetur ato në progresin e tyre. Edhe pse institucionet publike duhet të luajnë rolin e tyre duke ndihmuar dhe drejtuar sipërmarrësit socialë, këta të fundit hasen ndonjëherë me paragjykime apo stereotipe ndaj këtyre sipërmarrjeve nga nëpunësit civilë.

Në këtë rast, trajnimet dhe konsultimet janë të nevojshme edhe për nëpunësit civilë mbi këtë temë.

Të rinjtë ishin shumë të qartë në sondazh mbi këtë çështje. Ata theksuan rëndësinë që kanë institucionet publike të përmbushin rolin e tyre nëpërmjet:

- Mbështetjes financiare përmes granteve apo mekanizmave të tjerë
- Zhvillimit të politikave dhe mentorimit
- Përditësimit të kurrikulave në shkolla/universitete për sipërmarrjen sociale
- Ndryshimit të kuadrit ligjor për të mbështetur sipërmarrësit e rinj
- Përfundimit nga taksat
- Kredive me interes të ulët
- Krijimit të një rrjeti dhe krijimit të një hartë të sipërmarrjeve sociale

- Aksesit në burime si hapësirat e bashkëpunimit dhe teknologjia
- Proçeset e thjeshtuara rregullatore, së bashku me ofrimin e çmimeve, mbështetjes përmes konkurseve dhe njohjen publike
- Përfshirja në proçeset e vendimmarrjes

Gjithashtu të rinjtë u shprehën se institucionet arsimore apo organizatat mund t'i mbështesin ata nëpërmjet:

- Programeve të mentorimit dhe udhëzimit, trajnime, kampe pune, punëtori
- Përhapjes së informacionit dhe njohurive
- Krijimit të mundësive për rrjetëzim
- Shkëmbimeve të të rinjve për të ndarë praktikat më të mira
- Rritjes së ndërgjegjësimit dhe advokimit për mbështetje më të mirë
- Kurseve të specializuara dhe aktivitete të tjera të fokusuara në sipërmarrjen sociale. Është gjithashtu e rëndësishme që të mësohet sipërmarrja në moshë të re në mënyrë që të rinjtë të krijojnë mendësinë e sipërmarrjes. Mund të organizohet me programe inkubimi dhe Hackathons në mënyrë që të rinjtë të mund të parashtrojnë idetë e tyre me ndikim social.

Nëpërmjet kësaj mbështetjeje, sipërmarrësit e rinj socialë mund të frymëzohen dhe motivohen për të zhvilluar sipërmarrjet e tyre

Rekomandime për mekanizma mbështetës dhe burime arsimore/trajnuese për të rinjtë që të përfshihen në sipërmarrjen sociale

Gjatë fokus grupit, punonjësit rinorë dhanë rekomandime të ndryshme për nxitjen e sipërmarrjes sociale tek të rinjtë.

- Ndryshime në legjislacion për të inkurajuar të rinjtë që të ndërmarrin nisma të tilla.
- Institucionet publike përkatëse duhet të rrisin kapacitetet e stafit të tyre në lidhje përthithjen e fondeve në programet e BE-së dhe t'i shpërndajnë ato tek sipërmarrësit e rinj socialë.
- Ndryshim në mentalitetin për misionin e ndërmarrjeve sociale dhe punën e tyre.
- Fushata ndërgjegjësuese, punëtori dhe trajnime për të mbështetur sipërmarrjet sociale.
- Përfshirja e temës së ndërmarrjeve sociale dhe punës vullnetare në kurrikulën arsimore, si një modul i lëndës së orientimit të karrierës.
- Trajnime për stafin administrativ, mësuesit dhe prindërit mbi temën e ndërmarrjeve sociale.

Sipas gjetjeve të sondazhit, punonjësit rinorë sugjeruan ndryshime si mëposhtë:

- Instrumente më të mira ligjore në mbështetje të tyre
- Presion pozitiv në komunitet për të konsumuar produkte ose për të marrë shërbime të ofruara nga ndërmarrjet sociale

- Zhvillimi i takimeve me aktorë të ndryshëm si politikëbërësit, aktorët e biznesit, punonjësit rinorë, OJQ-të, dhe të rinjtë për të mbështetur iniciativat e reja dhe përparimin e këtyre nismave
- Krijimi i fondeve të fokusuara tek të rinjtë dhe opsioni i mikrofinancimit
- Ndërtimi i një komuniteti përmes strukturave mbështetëse siç janë inkubatorët, aksleratorët dhe rrjetëzimeve midis kolegëve, të cilët mund të lehtësojë bashkëpunimin dhe mësimin e përbashkët.
- Proçese më të thjeshtuara të regjistrimit dhe incentivave nëpërmjet reduktimit të taksave
- Sigurimi i aksesit në qendrat e teknologjisë dhe inovacionit do t'i ndihmojë sipërmarrësit e rinj të zhvillojnë dhe testojnë idetë e tyre.
- Formimi i një sindikatë ose shoqatë që nxit krijimin e sipërmarrjeve të reja sociale
- Përmes ekspozimit në media, çmimeve të ndryshme dhe fushatave të ndërgjegjësimit, publiku mund të vlerësojë përpjeket e sipërmarrjeve sociale.

Përmbyllje




Figure 5 Njohja e konceptit të ndërmarrjes sociale

Sipas anketës së kryer, vetëm 26 % e të rinjve ishin shumë të njohur me konceptin e sipërmarrjes sociale, 62 % ishin disi të njohur dhe 11 % e tyre nuk e njihnin shumë mirë këtë concept. 76% e tyre nuk ishin të përfshirë në projekte të sipërmarrjes sociale.

Gjithashtu 48% e punonjësve rinorë, siç tregon anketa, nuk e njihnin këtë concept.

Përmbledhje e Raportit mbi Nxitjen dhe Zhvillimin e Sipërmarrjeve Sociale Tek të Rinjtë

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga studimi online, analiza e sondazheve dhe diskutimet në grupet e fokusit, kemi përgatitur një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore. Këto të dhëna theksojnë nevojat dhe sfidat kryesore për nxitjen dhe zhvillimin e sipërmarrjeve sociale tek të rinjtë, dhe propozojnë masa konkrete për të adresuar këto çështje.

Sipas të dhënave është evidentuar një nevojë e domosdoshme për **ngritjen e kapaciteteve** përmes trajnimeve, seminareve dhe kurseve të dedikuara për nxitjen dhe zhvillimin e sipërmarrjeve sociale. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e **krijimit të një rrjeti** të qëndrueshëm kontaktesh, i cili do të mundësonte shkëmbimin e ideve dhe përvojave mes sipërmarrësve të rinj socialë.

Përshtatja dhe integrimi i **burimeve arsimore** janë faktorë kyç për nxitjen e sipërmarrjes sociale tek të rinjtë. Edukimi për sipërmarrjet sociale duhet të bëhet pjesë integrale e kurrikulës shkollore, duke ofruar module specifike në orientimin e karrierës dhe duke organizuar punëtori dhe trajnime praktike.

Nga ana tjetër, të rinjtë kërkojnë mbështetje të vazhdueshme përmes mentorimit dhe udhëzimeve të duhura për të zhvilluar aftësitë e tyre dhe për të ngritur sipërmarrje sociale të qëndrueshme. **Mentorimi i rregullt dhe udhëzimet strategjike** janë thelbësore për suksesin e këtyre nismave.

Qeveria dhe institucionet publike luajnë një rol të rëndësishëm në përpunimin e politikave që mbështesin sipërmarrjet sociale. **Transparenca** në menaxhimin e fondeve të dedikuara për sipërmarrjet sociale dhe **konsultimet e vazhdueshme me palët e interesuara** janë të

domosdoshme për rritjen e iniciativave të tilla. ***Një kuadër legjislativ i përmirësuar dhe stimujt fiskalë mund të nxisin zhvillimin e nismave të reja dhe të qëndrueshme të sipërmarrjes sociale.***

Një tjetër rekomandim i rëndësishëm është krijimi i një **harte të sipërmarrjeve sociale ekzistuese dhe promovimi i historive të suksesit**. Kjo iniciativë do të ketë një ndikim të madh tek sipërmarrësit e rinj socialë, duke u ofruar atyre modele për t'u ndjekur dhe duke inkurajuar një qasje pozitive ndaj sipërmarrjes sociale.

Në përfundim, ngritja e kapaciteteve, mbështetja përmes mentorimit, përmirësimi i politikave dhe legjislacionit, si dhe promovimi i historive të suksesit janë hapa të domosdoshëm për nxitjen dhe zhvillimin e sipërmarrjeve sociale tek të rinjtë. Këto masa do të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi të favorshëm dhe mbështetës për sipërmarrësit e rinj socialë, duke i ndihmuar ata të realizojnë potencialin e tyre dhe të sjellin ndryshime pozitive në shoqëri.

Referenca

European Commission (September 2019) *Albania Country Fiche. "Social enterprises and their ecosystems in Europe"*

Law Nr.75 (2016) *Summary: For youth* Retrieved June 2019 from <https://bitly.cx/E9Vo9>

Ministry of Finance and Economy, Republic of Albania. (2023). *National Employment and Skills Strategy 2030 [PDF]*. Retrieved June 2024 <https://rb.gy/8j4yv2>

Dolce Salato. (2021, May 24). KeBuono: *Da night club a pasticceria sociale*. Retrieved June 2024 from <https://www.dolcesalato.com/2021/05/24/kebuono-da-night-club-a-pasticceria-sociale/>

Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 118, (2016, June 24) Retrieved June 2024 <https://rb.gy/qn9uko>

KeBuono Pasticeri Sociale. (n.d.). Facebook. Retrieved June 2024 from <https://www.facebook.com/KeBuonoPasticeriSociale>

Hackett, M. T., & Roy, M. J. (2021). *Focus on the Balkans: Social Enterprise in Albania*.

Partners Albania, Analysis, Law 65(2016) on *Social Enterprise* Retrieved June 2024 from <https://rb.gy/835n72>

Council of Europe. (n.d.). *Albania: Chapter III*. Retrieved June 2024 from <https://rb.gy/wcprwk>

Council of Europe. (n.d.). *Albania: Chapter V*. Retrieved June 2024 from <https://bitly.cx/k34r>

Ministry of Health and Social Protection, Republic of Albania. (2023). *National Youth Strategy 2022-2029 [PDF]*. Retrieved from <https://bitly.cx/MJHJy>


Shtojca

Disa Praktikat dhe iniciativat të mira mbu qytetarinë aktive dhe sipërmarrjen sociale në Shqipëri

Emri:	New York Tirana Bagels
Shteti:	Shqipëri
E implementuar/e promovuar nga :	Qendra 'Të ndryshëm dhe Të Barabartë,'
Afati kohor/kohëzgjatja e praktikës më të mirë:	Në vazhdim
Zbatuesit e praktikave më të mira :	Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar drejtuar nga themeluesi i saj i OJF-së
Niveli Gjeografik i Zbatimit:	Vendore
Përshkrimi i praktikave më të mira:	Tirana Bagels është një sipërmarrje sociale e krijuar nga qendra Different and Equal, misioni i së cilës është të mbështesë gratë dhe fëmijët në nevojë në Shqipëri. New York Tirana Bagels është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga themeluesin i saj OJF-së. Ky është dyqani i parë bagel në Shqipëri që ofron bagels, sanduiçe, biskota dhe ëmbëlsira të tjera autentike amerikane,

	<p>përveç kësaj funksionon dhe si kafene. Ofron një shërbim shpërndarjeje dhe katering për evente të ndryshme, duke përfshirë dreka biznesi, dhe është i listuar në Baboon, një aplikacion shqiptar i porositjes dhe dërgesës së ushqimit. Kompania aktualisht operon vetëm në Tiranë. Klientët që synojnë të arrihen janë bizneset, organizatat e shoqërisë civile, ambasadat dhe familjet. New York Tirana Bagels vlerëson bashkëpunimin e bizneseve dhe organizatave të ndryshme që janë klientë besnikë dhe janë vetëdijshëm për misionin e saj si ndërmarrje sociale. Kompania ka punësuar pesë punëtorë me kohë të plotë dhe tre vullnetarë (zakonisht gjatë festave të fundvitit.) Punonjësit janë njerëz nga grupet e marginalizuara si gratë e papuna, gra që janë viktima të dhunës dhe emigrantët e kthyer. Investimi fillestar i kompanisë ishte rreth 25,000 euro, i cili u mbledh përmes një fushate për mbledhjen e fondeve.</p>
Ndikimi dhe vlera e shtuar për komunitetin:	Pjesa më e madhe e fitimeve, ndihmojnë në mbështetjen e

	<p>grave që janë viktima të dhunës dhe fëmijëve në nevojë, që është edhe misioni social i kompanisë, ndërsa pjesa tjetër ri-investohet në kompani. Vendimet merren nga administratori i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe anëtarët e Different and Equal. Klauzola e bllokimit të aseteve është e përcaktuar qartë në dokumentet e themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Sipas administratorit të kompanisë, Ligji për Ndërmarrjet Sociale ka disa kufizime. Ky shqetësim i madh nxjerr në pah faktin se ndërmarrjet sociale të krijuara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nuk njihen ligjërisht si të tilla. New York Tirana Bagels dëshiron të mbështetet nga shteti me incentiva konkrete financiare dhe kredi të buta për të rritur shanset e saj për të mbijetuar në treg.</p>
Faqe web-i (nëse ka):	http://newyorktiranabagels.com/

<p>Shtojca (foto të projektit, anekdoda të shkurtra në formë tregimesh, citate të shkurtra rreth ndikimit të projektit.) :</p>	
--	---

Emri:	“Ke Buono” Confectionery
Shteti:	Shqipëria
E implementuar/e promovuar nga :	ENGIM dhe Qendra Sociale Murialdo
Afati kohor/kohëzgjatja i praktikave më të mira:	2018 - deri tani
Zbatuesit e praktikave më të mira:	Sipërmarrje Sociale
Niveli Gjeografik i Zbatimit :	Vendore, Fier, Shqipëri
Përshkrimi i praktikave më të mira:	Shembulli i parë shqipëtar i një pasurie të konfiskuar nga grupet kriminale dhe e ripërdorur për qëllime sociale. Ndërmarrja është krijuar nga organizatat e shoqërisë civile “Engim” dhe “Social Center Murialdo”, në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Fier. KeBuono! u krijua në kuadër të

	<p>projektit "C.A.U.S.E - Përdorimi i Pronave të Konfiskuara për Ndërmarrjet Sociale", zbatuar nga Partners Albania, dhe financuar nga Bashkimi Europian. Në të kaluarën, kjo hapësirë ishte një disko dhe një klub nate. Sot është një vend takimi që përdoret për zhvillimin e punëtorive profesionale në fushën e pastërisë. «KeBuono» organizon kurse trajnime në teknikat bazë të prodhimit të pastave. Kursi zgjat 200 orë, 75% e të cilave zhvillohet në laboratorin e pastërisë me synimin për të dhënë të gjitha mjetet e mundshme pjeëmarrësve dhe për të fituar besimin në këtë profesion dhe për të lehtësuar rrugën drejt botës së punës.</p>
Ndikimi dhe vlera e shtuar për komunitetin:	<p>“KeBuono” e transformon gatimin dhe pjekjen e embëlsirave në mundësi për të promovuar përfshirjen sociale për njerëzit në nevojë, duke u mundësuar atyre të punësohen dhe të rifitojnë dinjitetin dhe rolin e tyre brenda shoqërisë. Ndërmarrja mbështet dhe forcon vetëbesimin duke ofruar një vend pune dhe duke ndihmuar të rinjtë që janë në rrezik, gratë që</p>

	<p>janë viktime të dhunës, të divorcuara ose të martuara me burra abuzivë dhe të dënuar me burg.</p> <p>Engim, në bashkëpunim me Qendrën Sociale Murialdo dhe Fondacionin San Zeno pranë Agjencisë Italiane për Bashkëpunim e Zhvillim, jep bursa për gratë në vështirësi socio-ekonomike. Për ata që kanë përfituar një bursë, ka edhe një grant pune 5-mujore në një furrë buke apo pastiçeri në qytetin e Fierit.</p>
<p>Faqe web-i (nësa ka):</p>	<p>N/A</p>
<p>Shtojca (Shtojca (foto të projektit, anekdoda të shkurtra në formë tregimesh, citate të shkurtra rreth ndikimit të projektit.) :</p>	



Ky raport u realizua nga People in Focus si organizatë partnere në zbatimin e projektit “Fuqizimi i qytetarisë sipërmarrëse për Ndryshim Social- EPIC”, i cili është i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian.

Author: © People in Focus

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose përcillet në asnjë formë apo me asnjë mjet, qoftë elektronik (CD-Rom, Internet etj.) apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo çdo sistem ruajtje ose nxjerrje informacioni, pa pasur miratimin paraprak me shkrim nga People in Focus ose partnerët e projektit.

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni People in Focus:

Adresa Rr: Islam Alla, Pall.1, Nr.10 Njësia Administrative Nr.10, Kodi Postar 1057 Tiranë, Shqipëri

Webpage: www.peopleinfocus.org

Facebook page: People in Focus Albania

Instagram Page: [peopleinfocusalbania](https://www.instagram.com/peopleinfocusalbania)

Tel: +355 42224927